(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

### Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik:**  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

**pesha për Propozimin Ekonomik:**  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

### Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHËNIM:** 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të

dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

## **22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të

përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

### **O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e

gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

#### 4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

### D. DHËNIA E KONTRATËS

#### 23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

#### 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

### DH. ANKESAT

#### 25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të

paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    - 2. Njoftimin e Kontratës;
    - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- 
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

|                                           |  |
|-------------------------------------------|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| 1   | 2                                                        | 3              | 4               | 5                    |         |
|-----|----------------------------------------------------------|----------------|-----------------|----------------------|---------|
| Nr. | Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike | Sherbim / muaj | Çmimi për njësi | Çmimi total (3 x 4X) | Afati   |
| 1   |                                                          |                |                 |                      | 12 MUAJ |

|                                           |                    |  |  |       |
|-------------------------------------------|--------------------|--|--|-------|
|                                           | <b>Çmimi total</b> |  |  | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                    |  |  |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                    |  |  |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                    |  |  |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                    |  |  |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                    |  |  |       |
| <b>Vula</b>                               |                    |  |  |       |
| <b>Datë</b> _____                         |                    |  |  |       |

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe

---

informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

### **Nënshkrimi Vula**

### **Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

### Sipas termave të references

---

**Shtojca 7.**

**(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**

**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)**

**Shërbimi që kërkohet:**

**Afatet e ekzekutimit:**

---

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Marrëveshje shërbimi mirëmbajtje dezeinfektim N/Stacione” **me afat realizimi 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.**

Detyrat: Sipas Specifikimeve

Shpërndarja:

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Do të jetë sipas nënstacioneve të përcaktuara në Relacionin teknik nga grupi i punës.

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

---

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

[Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:](#)

---

Arsyeja pse nuk ndahet në lote: Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, objekti i kontratës përbën një shërbim unik të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit (DDD), i cili ka natyrë të njëjtë dhe funksion të vetëm, duke u konsideruar një proces teknik i pandarë. Të gjitha ndërhyrjet që përbëjnë këtë shërbim janë të ndërruara dhe përbëjnë pjesë të të njëjtit cikël higjieno-sanitar.

Së dyti, realizimi i shërbimit kërkon koordinim teknik të vazhdueshëm, përdorimin e pajisjeve dhe kimikateve të miratuara, si dhe angazhimin e personelit të specializuar nën të njëjtin plan operacional. Për shkak të natyrës së këtij procesi, ndarja në lote do të sillte fragmentim të përgjegjësi, vështirësi në kontrollin dhe monitorimin e punës, si dhe rrezik për mospërputhje në trajtime, duke cenuar efektivitetin e rezultatit përfundimtar.

Së treti, ndarja në lote do të krijonte konfuzion organizativ, rritje të kostove administrative, vonesa në zbatimin e kontratës, dhe vështirësi në sigurimin e cilësisë së njëtrajtshme në të gjitha ndërhyrjet. Kjo do të binte ndesh me parimin e efikasitetit, ekonomikitetit dhe proporcionalitetit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik.

Në përfundim, për shkak të arsyeve të natyrës teknike, funksionale dhe organizative të përmendura më sipër, Njësia e Prokurimit gjykon se zhvillimi i procedurës si një kontratë e vetme, pa ndarje në lote, është zgjidhja më e drejtë dhe në përputhje me frymën e ligjit nr. 162/2020 dhe të VKM nr. 285/2020 të ndryshuar, duke siguruar një zbatim më të efektshëm, me cilësi dhe pa vonesa, në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktor.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

---

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

---

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të MK, që është brenda vlerës kufi të

përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 40 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**1.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë për shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore me kod II.8.B.

**Argumentim:** Ky kriter bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)”, i ndryshuar. Sipas këtij vendimi, nënkategoria II.8.B parashikon dhënien e licencës për ofrimin e shërbimeve ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (deratizim, dezinfektim, dezinfektim), të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik. Për të siguruar që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik dhe ligjor, kërkohet paraqitja e kësaj licence.

**1.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë për shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore II.8.A.

**Argumentim:** Ky kriter mbështetet në të njëjtin kuadër ligjor, përkatësisht në VKM nr. 538/2009, i ndryshuar, ku nënkategoria II.8.A përcakton licencën për ofrimin e shërbimeve të ekspertizës higjeno-shëndetësore. Kjo licencë është e nevojshme për garantimin e profesionalizmit dhe aftësisë shkencore të subjektit që merr përsipër vlerësime dhe masa lidhur me higjienën dhe shëndetin publik. Kërkimi i kësaj licence lidhet ngushtë me sigurinë e kryerjes së procedurave në përputhje me standardet shëndetësore.

**1.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë II.5.A.3 për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve. (Produkteve të rrezikshme dhe me rrezikshmeri të lartë.)

**Argumentim:** Bazuar në VKM nr. 538/2009 dhe në ndryshimet pasuese, nënkategoria II.5.A.3 përcakton licencën për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve, të cilat konsiderohen produkte kimike me rrezikshmëri të lartë. Kjo licencë kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik ofron vetëm produkte të certifikuar dhe të kontrolluara sipas legjislacionit shqiptar dhe atij europian për mbrojtjen e bimëve dhe mjedisit. Kriteri është i domosdoshëm pasi shërbimet e DDD dhe mirëmbajtjes së vegjetacionit shpesh përdorin pesticide dhe herbicide që hyjnë në këtë kategori.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi i sipërcituar për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës. Shërbimet e kërkuara objekt kontrate nuk mund të

---

ofrohen nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato subjekte të licensuara/autorizuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) ndaj duke qenë se kriteri është në proporcion me objektin e prokurimit të kësaj procedure vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet ta disponojnë dhe paraqesin këtë dokument.

**1.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 20 (njet) punonjës të punësuar dhe nga keta të paktën të punësuar minimun 2 (dy) persona që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- 2 (dy) “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”
  - 1 (një) Përgjegjës shërbimi/drejtuës teknik (Biolog/Kimist/Agronomi /Shëndet public etj)
  - 1 (një) agronom, i pajisur me certifikate vlerësimi ndikimi në mjedis, për të cilin duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe licencën përkatëse
  - 1 (një) kimist, kontratë pune dhe diplomë
  - 5 (pesë) punonjës aplikues të lëndëve DDD
  - 5 (pesë) punonjës kopshtarie të pajisur me certifikatë trajnimi për kopshtari/gjelbërim
  - 5 punonjës shofere të pajisur me leje drejtimi përkatëse
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
  - Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe në nenin 41, pika 4/ b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes në punë.

Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë rekomandohet të jenë kur kryhen shërbime, të cilat rrezikojnë në mënyrë të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjesve që do të angazhohen. Ky person do të jetë përgjegjës për të përmbushur kërkesat

---

e dokumentit “ANEKSI 1 - Standartet minimale te shendetit, sigurise dhe mjedisit per kontraktoret” bashkelidhur ne dokumentet e tenderit.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 20 (njetet) punonjes dhe 2 (dy) persona pergjegjes per sigurine dhe shendetin është në funksion të zërave të shërbimeve që kërkohen të realizohen, ndarjes ne disa gupe njeheresh per realizimin e sherbimeve, zerave te preventivit ku pothuajse te gjithë zerat paraqisin rezikshmeri te larte dhe vendodhjes se ku do të kryhen keto shërbime që përfshijnë zona të ndryshme gjeografike pothuajse ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**1.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profileve të mëposhtme, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, ose me kontratë shërbimi konkretisht:

- 2 (dy) “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”
- 1 (një) pergjegjes sherbimi/drejtues teknik (Biolog/Kimist/Agronomi /Shëndet public etj)
- 1 (një) agronom, i pajisur me certifikate vlerësimi ndikimi në mjedis, për të cilin duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe licencën përkatëse
- 1 (nje) kimist, kontratë pune dhe diplomë
- 5 (pesë) punonjës aplikues të lëndëve DDD
- 5 (pesë) punonjes kopshtarie të pajisur me certifikatë trajnimi për kopshtari/gjelbërim
- 5 punonjes shofere te pajisur me leje drejtimi perkatese

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, hartuar nga AK.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike.

Duke vlerësuar që shërbimi, objekt prokurimi ka një ndikim të drejtëpërdrejtë mjedis dhe ne shendetin e punonjesve vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit/drejtuesi teknik të jetë nje njeri i afte si inxhinier mjedisi/ Biolog/Kimist/Agronomi /Shëndet public, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike. Përgjegjësi i shërbimit me

---

profil inxhinier mjedisi ose ekspert mjedisi siguron realizimin e shërbimit në përputhje me legjislacionin në mënyrë të tillë që mbrojnë biodiversitetin, zgjedhjen e metodave më të përshtatshme të kryerjes se shërbimit, që nuk shkaktojnë ndotje shtesë.

Inxhinjeri Agronom do te duhet per shkak te shërbimeve qe kerkohet si objekt kontrate ne lidhje me mirmbajtjen e vegetacionit ku nje nga pikat kryesore lidhet me hedhjen e lendeve kimikate per tharjen e barit ku rrezikshmeria eshte e larte dhe si pasoje certifikata e Vleresimit Ndikimit ne Mjedis eshte e domosdoshme per shkak dhe te demeve qe kto kimikate mund te shkaktojne ne mjedis dhe gjithashtu mirmbajtja e drureve dhe shkurreve ku do te nevojitet krasitje prerje etj. dhe nevoja e nje Inxhinjeri Agronom eshte e pashmangshme.

Eshte kerkuar gjithashtu nje Inxhinjer Kimist i cili do duhet per te gjitha kiikatet, pesticidet, helmet e ndryshme qe do te perdoren ne kte kontrat ne perputhje me specifikimet teknike dhe shërbimeve objekt prokurimi.

Punonjësit e shërbimit janë të nevojshëm për të kryer të gjitha zërat e shërbimit, objekt prokurimi, si shërbimin DDD si dhe gjithashtu dhe mirmbajtjen e vegetacionit dhe si pasoje punonjesit duhet te jene te trajnuar dhe certifikuar duke marre parasysh dhe ambjente me nje rrezikshmeri te larte ku do te duhet te operojne të përcaktuar në specifikimet teknike.

Numri i punonjësve të shërbimit është përcaktuar nga ekspert i certifikuar për auditim mjedisor dhe vlerësim të ndikimit në mjedis, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka optimizuar numrin e punonjësve të shërbimit, bazuar në frekuencat përkatëse të secilit zë shërbimi dhe kohëzgjatjen e kontratës.

**1.3.7** Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet te deklarojne qe posedojne ne pronesi ose me qera pajisjet me të cilat do të kryhet shërbimi, te vertetuara me faturë (dhe te shoqeruara me skeda teknike ku te pasqyrohen te dhenat perkatese) apo me kontrate qeraje.

1. Kurthet multifunksional për brejtës. (minimum 500 cope)
2. Pajisje elektronike vibruese per largimin e gjarprinjeve. (minimum 200 cope)
3. Karta ngjitese per ambjente te brendshme. (minimum 500 cope)
4. Pajisje ultratinguj per largimin e brejtesave. (minimum 200 cope)
5. Pompa per sperkatjen e produktit per tharjen e barit dhe shkurreve (minimum 10 cope)
6. Gërshërë për prerje pemësh dhe shkurresh
7. Makineri për prerje degësh/shkurresh (me bisht mbi 4 metra)
8. Veshje te posacme pune dhe pajisje per mbrojtjen dhe shendetin ne pune (syze, veshje, doreza etj); (minimum 30 cope)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**1.3.8** Operatori Ekonomik duhet te paraqesi dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës

| Nr/R | Mjetet                                                                      | Sasia  | Gjendja             |
|------|-----------------------------------------------------------------------------|--------|---------------------|
| 1    | <i>Automjete ATP per transport personeli dhe materiale per sherbime DDD</i> | 3 copë | Pronësi ose me qira |
| 2    | <i>Aparate mjegulluese me pompë me presion, të montuar në kamionçinë</i>    | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| 3    | <i>Kamioncine vetshkarkuese me kapacitet mbajtes 1-1.5 ton</i>              | 1 copë | Pronësi ose me qira |
| 4    | <i>Autovinc Kulle (minimumi 23 m)</i>                                       | 2 copë | Pronësi ose me qira |

Mjetet me lart te përmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 10) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës:** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) si dhe certifikate transporti (akt - miratimi higjeno – sanitar) për sherbime DDD të leshuara nga autoritetet perkatese (ISHSH) për subjektin dhe për automjetet për transport njerezisht dhe materiale DDD si dhe gjithashtu për mjetet tip Autokulle për punime në lartësi mjetet duhet të jenë të pajisura me Raport Inspektimi Konformiteti për pjesën e krahut për ngritjes në lartësi nga një subjekt i Akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA).

#### Ose

- b) **Kontratën e marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë specifike për objektin që prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) si dhe certifikate transporti (akt - miratimi higjeno – sanitar) për sherbime DDD të leshuara nga autoritetet perkatese (ISHSH) për subjektin dhe për automjetet për transport njerezisht dhe materiale DDD si dhe gjithashtu për mjetet tip Autokulle për punime në lartësi mjetet duhet të jenë të pajisura me Raport Inspektimi*

**Për secilin prej mjeteve të paraqiten fotografi të tyre.**

**Argumentimi:** “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe sipas kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/pajisjeve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit. Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjestim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës.

**1. Automjete ATP për transport personeli dhe materiale për shërbime DDD (3 copë)**

Këto automjete janë të domosdoshme për transportin e stafit të specializuar dhe materialeve/pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve DDD në nënstacionet elektrike dhe ambientet përkatëse. Posedimi i këtyre mjeteve siguron ndërhyrje të shpejtë dhe efikase, si dhe respektim të kushteve higjieno–sanitare gjatë transportit.

**2. Aparat mjegullues me pompë me presion, i montuar në kamionçinë (1 copë)**

Pajisja është thelbësore për kryerjen e trajtimeve dezinfektuese dhe dezinfektuese në hapësira të mëdha të jashtme. Montimi në kamionçinë rrit lëvizshmërinë dhe mbulimin efektiv të zonave, duke garantuar efikasitet në shpërndarjen e substancave kimike në sipërfaqe të gjera. Ky mjet është i lidhur drejtpërdrejt me kërkesat e kontratës për DDD.

**3. Kamionçinë vetshkarkuese me kapacitet mbajtës 1–1.5 ton (1 copë)**

Kjo makineri është e domosdoshme për transportimin dhe shkarkimin e materialeve të përdorura në mirëmbajtjen e vegjetacionit (degë, mbetje bimore, inerte të lehta). Përdorimi i saj

---

siguron shpejtësi dhe lehtësi operationale, duke përmbushur kërkesat e kontratës për mirëmbajtje teknike dhe mjedisore.

#### 4. Autovinc Kullë (minimumi 23 m) – 2 copë

Duke marrë shkas nga njohja e terrenit dhe problematikat që lindin për sa i përket bimësisë përkatësisht drurëve të lartë është parashikuar që Autoriteti të kërkojë vinca të cilët bëjnë të mundur krasitjen dhe kujdesjen për çdo anomali për sa i përket rrezikshmërisë në nënstacion. Keto mjete janë te nevojshme për ndërhyrjet në lartësi, kryesisht në pastrimin dhe krasitjen e vegjetacionit përreth linjave dhe nënstacioneve, si dhe për sigurinë e punonjësve gjatë këtyre operationeve. Disponimi i autovincave siguron që shërbimet të kryhen në përputhje me standardet e sigurisë në punë dhe pa pengesa operationale.

- 1.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Certifikatat e prodhuesit ISO 9001 të kërkuara në specifikimet teknike, AK do njohë edhe nga distributorët e autorizuar prej tyre.

**AK do të njohë si të vlefshme edhe certifikatën ISO 9001 të prodhuesit të mallrave, e paraqitur nga operatorë ekonomikë që janë distributorë të autorizuar të tij,** për sa kohë që certifikata është e vlefshme dhe mallrat e ofruara janë prodhuar nga subjekti i certifikuar.

Ky trajtim siguron që kërkesa për certifikim të mbetet e vlefshme në funksion të cilësisë së mallrave dhe përputhshmërisë me standardet, pa përjashtuar nga pjesëmarrja operatorë që janë distributorë të ligjshëm e të autorizuar.

- 1.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të mjedisit e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

**1.3.11** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e shërbimeve DDD pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Në objektin e kontratës janë parashikuar shërbime me kimikate/helme, të cilat kanë impakt në mjedis si dhe rrezikojnë në mënyrë të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjësve që do të angazhohen për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe personelit tone që punon në këto ambiente, kështu që rrjedhimisht kërkesat për dy certifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 janë kërkesa të nevojshme.

Standarti ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit” është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë manaxhimi i duhur i çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi manaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001. Perfitimet kryesore për këtë sistem manaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potencialë, komuniteti, autoritetet; zvogelimin e shpenzimeve nepermjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të cojë në pagesën për demshperblim dhe dëm; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja.

Standarti ISO 45001 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të

---

jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj. Për më tepër, që në kriteret teknike AK ka kërkuar ndër të tjera që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të caktuar, minimal prej 20 punonjës, të cilët duhet të sigurojnë AK shërbimet e nevojshëm gjatë gjithë periudhës që do të shtrihet marrëveshja kuader.

Në këtë kuptim, AK në vendosjen e kriterëve të mësipërme kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre.

**1.3.12** Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kësaj kontrate, duke qenë se shërbimet do të kryhen edhe brenda nënstacioneve elektrike me kushte të veçanta teknike dhe sigurie, duhet të disponojë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar ose me kontratë shërbimi për të gjithë periduhën e shërbimit për secilën nga certifikatat e mëposhtme:

- Dhënia e ndihmës së parë në punë;
- Siguria në pajisje elektrike;
- Zonat ATEX (Atmosfera Potencialisht Shpërthyes);

Për vërtetimin e këtij kriteri, duhet të paraqesë certifikatat e trajnimit përkatëse (Këto certifikata mund t'i disponojnë të njëjtët punonjës ose punonjës të ndryshëm, por për secilën prej tyre duhet të jenë të paktën 3 punonjës të certifikuar).

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Bazuar në termat e references dhe specifikimet teknike, operatorët ekonomike duhet të provojnë disponimin e ketyre dokumenteve, të cilat janë të domosdoshme për të garantuar aksesin dhe realizimin e kontratës me sukses brenda territoreve ku do të realizohet shërbimi objekt kontrate.

**1.3.13** Operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient në pronësi ose me qera të dedikuar për **magazininin e lëndëve biocide dhe/ose pesticide**, i cili të jetë i pajisur me **Akt-Miratim Higjeno-Sanitar**, të lëshuar nga **Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)**, në përputhje me **ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”**, i ndryshuar. Për vërtetimin e të drejtës së përdorimit të ambientit, ofertuesi duhet të paraqesë: **Certifikatën e pronësisë ose Kontratën noteriale të qirasë për ambientin në fjalë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë

---

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe Ligjin nr.9632, date 30.10.2006 ”Per sistemin shendetesor publik” te ndryshuar. Ky kriter eshte i domosdoshem per te garantuar perdorimin e kontrolluar te substancave, mbrojtjen e shendetit publik dhe te punonjesve, si dhe realizimin me sukses te kontrates ne perputhje me standartet teknike dhe ligjore.

**Shënim:** Operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*
- **Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:**
  - Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
  - Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe*

---

**çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari, përpara publikimit të shpalljes së fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit për të vërtetuar plotësimin e kriterëve duhet të dorëzojë dokumentacionin provues: Deklaratë për punonjës që ka ofertuar në procedurën e prokurimit. (Deklaratat e Konfidentalitetit do të nënshkruhen në momentin e lidhjes së kontratës)

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shenim:** në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet që **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotësojë sa më sipër.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi                                                                                                                                              | Përgjigja |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----     |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                            | -----     |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                           | -----     |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                      | -----     |
| Telefoni:                                                                                                                                                 | -----     |
| E-mail:                                                                                                                                                   | -----     |

### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| Deklarata                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>                          |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>                                                                                                                                                                  |
| <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p> |
| <p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p>                                                                                                                                                                                                  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p>                                                                                                                                             |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____</p>                                                               |
| <p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>                                                                                      |
| <p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |      |            |   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------------|---|
| të legjislationit në fuqi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |      |            |   |
| Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |      |            |   |
| Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislationi në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.                                                                                                                                                                                                                              |      |            |   |
| Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |      |            |   |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |      |            |   |
| Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. |      |            |   |
| Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |      |            |   |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |      |            |   |
| Sqarime                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | nëse | vlerësohet | e |
| nevojshme _____                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |      |            |   |

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:</p> <p>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.</p> <p>Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.</p> <p>Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:</p> <p>çmimet;<br/>metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;<br/>qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,<br/>paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.</p> |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

<sup>7</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

